




KREDI E RE PËR NJË PROJEKT TË RËNDËSISHËM TË INFRASTRUKTURËS PUBLIKE



Tirana Bank ka kënaqësinë të njoftojë se kohët e fundit është finalizuar me sukses aprovimi dhe fillimi i disbursimit të kredisë të përbashkët më të madhe dhënë biznesit shqiptar gjatë dy viteve të fundit nga bankat lokale.

Financimi i ri në shumën rreth EUR 26 milionë, me afat të gjatë maturimi, i është akorduar shoqërisë koncesionare “Rruga Orikum–Llogara”, e cila ka marrë përsipër realizimin e infrastrukturës së re rrugore Orikum–Dukat në zonën e Vlorës.

Ky investim, i cili përfshin edhe ndërtimin e disa urave dhe të një tuneli panoramik në këtë aks rrugor, synon rritjen e standardit të sigurisë rrugore dhe modernizimin e infrastrukturës, për zgjerimin e mëtejshëm të sektorit të turizmit në bregdetin tonë jugor.

Ky financim i përbashkët akordohet nga bankat lokale: Tirana Bank, Intesa San Paolo Bank dhe OTP Bank Albania, me objektiv rritjen e mbështetjes për zhvillimin e ekonomisë lokale. Tirana Bank ka realizuar strukturimin e financimit dhe ka udhëhequr negociatat me palët e përfshira në këtë transaksion.